

Formular për syllabus të lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FAKULTETI I ARTEVE
Titulli i lëndës:	IMAZHET DIXHITALE DHE MEDIAT E REJA I
Niveli:	BA
Statusi lëndës:	OBLIGATIVE
Viti i studimeve:	VITI III - SEMESTRI V DHE VI
Numri i orëve në javë:	4
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Fakulteti i Arteve - Studio e Fotografisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ast. Yllka Fetahaj
Detajat kontaktuese:	yllka.fetahaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda “Imazhet Dixhitale dhe mediat e reja I” fokusohet në zhvillimin e aftësive të avancuara teknike dhe konceptuale në fotografinë bashkëkohore. Studentët punojnë me ndriçimin artificial dhe natyral, përdorin filtra, ekspozim të gjatë, retouching digjital dhe procese alternative për të krijuar imazhe eksperimentale dhe profesionale.</p> <p>Në pjesën e dytë të kursit, theksi vendoset në projektet konceptuale dhe eseja fotografike, duke përfshirë analiza vizuale, prezantime dhe ekspozitë përfundimtare.</p>
Qëllimet e lëndës	<ul style="list-style-type: none"> - Të aftësojë studentët në përdorimin profesional të ndriçimit, filtrave dhe teknikave digjitale. - Të nxisë eksplorimin eksperimental përmes ekspozimit të gjatë, rikrijimit dhe proceseve alternative. - Të zhvillojë aftësi konceptuale për të krijuar dhe prezantuar projekte të strukturuar fotografike. - Të inkurajojë mendimin kritik dhe përdorimin e mjeteve digjitale për komunikim vizual.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorë ndriçimin artificial dhe natyral në mënyrë të kontrolluar për qëllime artistike dhe komerciale. - Aplikoje teknika si <i>long exposure, flash synchronization, color filters</i> dhe <i>photo manipulation</i>.

	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillojë projekte të strukturuar me qasje konceptuale, përfshirë eseja fotografike. - Zbatojë metoda alternative për prodhimin e imazhit dhe prezantimin e tij përfundimtar.
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)	
Aktiviteti	Orë Ditë Gjithsej
Ligjërata	2 1 30 orë
Ushtrime teorike	- - -
Ushtrime praktike (studio/laborator)	1 1 15 orë
Ushtrime në teren	1 1 15 orë
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0.5 - 10 orë
Kollokfiume, seminare	- 2 5 orë
Detyra të shtëpisë	1 - 30 orë
Koha e studimit vetanak të studentit	2 - 60 orë
Përgatitja përfundimtare për provim	- - 10 orë
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	- - 5 orë
Projektet, prezantimet, etj	- - 25 orë
Totali	205 orë
<p>Shpjegim i shkurtër i përlogaritjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● 4 orë mësim në javë × 15 javë = 60 orë kontakti (30 ligjërata + 15 praktikë + 15 terren). ● Pjesa tjetër është shpërndarë sipas standardeve akademike për punë vetanake, ushtrime dhe projekte. ● Kjo është e përputhshme me një kurs që ka 6 ECTS, pasi 1 ECTS = ~25–30 orë ngarkesë pune. 	
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Metodologjia e mësimdhënies për këtë kurs bazohet në një qasje të integruar që kombinon teorinë, praktikën, analizën vizuale dhe zhvillimin e projekteve fotografike digjitale.</p> <p>Procesi i mësimdhënies zhvillohet në mënyrë progresive – nga njohuritë teknike mbi dritën dhe kamerën deri te zbatimi i tyre në projekte konceptuale dhe eksperimentale individuale ose në grup.</p> <p>Ligjërata interaktive me analiza vizuale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Parashtrimi i koncepteve teorike për fotografimin digjital: ndriçimi, ekspozimi, ngjyra, kompozicioni dhe balanca vizuale.

- Analiza e punëve të fotografëve bashkëkohorë që punojnë me teknologji digjitale, dritë artificiale dhe manipulim të imazhit.
- Diskutim kritik mbi mënyrat se si teknologjia ndikon në procesin krijues dhe në perceptimin estetik.

Punë praktike dhe projekte individuale / në grup

- Studentët realizojnë seri fotografike përmes fazave të: **planifikimit, fotografimit, përpunimit digjital dhe prezantimit vizual.**
- Puna praktike në studio, në terren dhe në ambient digjital është thelbësore për të lidhur teorinë me praktikën.
- Projektet zhvillohen individualisht ose në grup, përfshirë **ese fotografike, rikrijime dhe procese alternative.**

Workshop-e dhe ushtrime eksperimentale

- Seanca intensive të fokusuar në teknika si: **ekspozimi i gjatë me flash, filtrat ngjyrë, portreti në studio, portreti me dritë natyrale dhe proceset alternative digjitale.**
- Eksperimentim me formën, dritën, teksturën dhe ngjyrën për të nxitur krijimtarinë dhe kërkimin personal.
- Përdorimi i kombinimeve të ndriçimit dhe mjeteve digjitale për të krijuar efekte ekspresive.

Kritikë dhe feedback formativ

- Studentët paraqesin vazhdimisht punët e tyre në klasë përmes kritikave të hapura dhe të strukturuar.
- Qëllimi është të nxisë reflektimin, diskutimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procesit krijues bazuar në komentet e mësimdhënësit dhe kolegëve.
- Procesi i kritikës vizuale është pjesë integrale e vlerësimit formativ.

Analizë vizuale dhe kërkim konceptual

- Zhvillimi i aftësisë për të lexuar dhe interpretuar imazhin fotografik përmes analizës formale dhe përmbajtësore.
- Kërkim mbi temat që trajtohen në projektet personale për të ndërtuar një koncept të qëndrueshëm artistik dhe estetik.
- Përdorimi i referencave historike dhe bashkëkohore për të ndërtuar një bazë teorike që mbështet praktikën.

	<p>Përdorimi i teknologjive digjitale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ushtrime që zhvillojnë aftësitë në përpunimin e imazhit (Lightroom, Photoshop, InDesign) dhe përgatitjen e prezantimeve profesionale. - Integrimi i mjeteve digjitale në ndërtimin e portofolios dhe në finalizimin e projekteve. - Përdorimi i software-ve për simulime të ndriçimit, filtrave dhe efekteve të avancuara. <p>Prezantime të strukturuar dhe dokumentim i procesit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studentët mësojnë të artikulojnë në mënyrë profesionale procesin e tyre krijues përmes prezantimeve vizuale dhe shkrimore. - Përdorimi i portofolios si mjet për të ndjekur zhvillimin e ideve dhe progresin teknik gjatë gjithë semestrit. - Dokumentimi i vazhdueshëm i punës në studio, në terren dhe në laborator si pjesë e vlerësimit përfundimtar.
<p>Metodat e vlerësimit:</p>	<p>Vlerësimi në këtë lëndë bazohet në një kombinim të vlerësimit formativ dhe përfundimtar, me fokus në zhvillimin teknik, estetik dhe konceptual të studentit gjatë gjithë procesit krijues.</p> <p>Qëllimi është të vlerësohet jo vetëm rezultati final, por edhe procesi i punës, përfshirja aktive në diskutime, reflektimi kritik dhe aftësia për të zhvilluar një qasje personale në fotografi.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja dhe angazhimi në ligjërata dhe praktikë – 20% - Detyra praktike dhe ushtrime individuale – 30% - Projekti semestral – 30% - Prezantimi final / ekspozita – 20%
<p>Literatura</p>	
<p>Literatura bazë:</p>	<p><i>Time –Life: The Techniques of Photography</i> <i>Lou Jacobs JR.: Studio Lighting</i> <i>Fil Hunter: Light, Science & Magic: An Introduction to Photographic Lighting</i> <i>Bruce Barnbaum: The Art of Photography</i> <i>Andrew Faulkner: Adobe Photoshop Classroom</i></p>
<p>Literatura shtesë:</p>	<p>Ansel Adams – <i>The Camera, The Negative, The Print</i> Michael Langford – <i>The Darkroom Handbook</i> John Berger - <i>Ways of Seeing</i> William Zinsser - <i>On writing well</i></p>
<p>Burimet: https://www.biblioteka-ks.org/ https://bibliotekadigjitale-ks.org/documents</p>	

<https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,137>
<https://www.gutenberg.org/>
<https://www.springer.com/gp/open-access/books>
<https://doabooks.org/>
<https://www.magnumphotos.com/>
<https://aperture.org/>
<https://lensculture.com/>
<https://www.tate.org.uk/art/art-terms/p/photography>
<https://photoresourcehub.com/>
<https://masters-of-photography.com/>

Java	Tema / Njësia Mësimore	Përmbajtja Kryesore	Aktivitetet Mësimore	Detyra / Vlerësimi
1	<i>Hyrje në lëndë dhe prezantimi i syllabusit</i>	Prezantimi i planit, metodologjisë dhe mënyrës së vlerësimit.	Diskutim hyrës, prezantim lënde	Ditar reflektiv
2	<i>Long Exposure me flash</i>	Kombinimi i dritës natyrale dhe artificiale përmes ekspozimit të gjatë.	Ligjëratë dhe ushtrime	Detyra 1. Long exposure with flash
3	<i>Ushtrime praktike Long Exposure me flash</i>	Realizimi i një serie fotosh "Light and Motion"	Ushtrime praktike ne studio	Ushtrime praktike
4	Prezantim	Kritikë vizuale dhe rishikim teknik.	Diskutim në klasë	Feedback formativ
5	<i>Drita natyrale dhe artificiale: Bazat e ndriçimit</i>	Shpjegimi i teknikave bazë të përdorimit të dritës natyrale dhe artificiale për fotografi.	Ligjëratë teorike dhe demonstrim në studio	Detyra 2. Fotografim portreti në studio.
6	<i>Vazhdim: Portreti në studio</i>	Eksperimentim me dritë artificiale në studio për të kontrolluar ndriçimin dhe hijet.	Ushtrime praktike	Ushtrime praktike
7	<i>Portreti me dritë natyrale</i>	Puna me dritë direkte, e butë dhe reflektuar.	Ushtrime praktike ne terren.	Detyra 3: Fotografim

				portreti në drite natyrale.
8	<i>Kritika vizuale e punëve</i>	Diskutim kolektiv për rezultatet.	Prezantim dhe analizë	Feedback formativ
9	<i>Filters</i>	Përdorimi i filtrave color-photo gels dhe bardh e zi për të krijuar efekte të ndryshme vizuale.	Ligjëratë + diskutim mbi shembuj vizualë	Pjesëmarrje aktive
10	<i>Vazhdim: Efektet vizuale përmes filtrave color</i>	Eksperimentim me filtrat color në studio	Ushtrime praktike në studio	Detyra 4: Filtrat
11	<i>Vazhdim: Efektet vizuale përmes filtrave BW, ND</i>	Eksperimentim me filtrat BW dhe ND filters ne terren.	Ushtrime praktike në terren.	Ushtrime
12	<i>Vazhdim: Macro filters</i>	Shpjegimi i teknikave për fotografimin e objekteve të vogla duke përdorur makro-lens apo filter për detaje të imta.	Ushtrime praktike në studio dhe terren.	Ushtrime
13	<i>Vizita në galeri ose studio</i>	Njohje me praktikën bashkëkohore të fotografisë.	Vizitë studimore	Ditar reflektiv
14	<i>Kritikë dhe përmirësim i projekteve</i>	Mbrojtje e punës përfundimtare para klasës.	Kritikë kolektive	Feedback formativ
15	<i>Esheja fotografike</i>	Esheja fotografike – koncepti dhe struktura	Ligjëratë + diskutim	Detyra 5: Esheja fotografike
16	<i>Prezantim Photo Essay</i>	Prezantimi i photo essay	Prezantim + kritikë	Prezantim

17	<i>Rikrijimi i fotografive/ pikturave të vjetra</i>	Shpjegimi i procesit të rikrijimit të një fotografie apo pikturë duke analizuar dritën, karakterin, veshjen dhe gjithë skenën.	Punë praktike në studio	Detyra 6. <i>Rikrijimi i fotografive/ pikturave të vjetra</i>
18	<i>Vazhdim i rikrijimit të fotografive të vjetra</i>	Rikrijimi i një fotografie të vjetër duke përdorur teknika të ngjashme me origjinalin	Punë praktike në studio	Ushtrime
19	<i>Vazhdim i rikrijimit të fotografive të vjetra</i>	Rikrijimi i një fotografie të vjetër duke përdorur teknika të ngjashme me origjinalin	Punë praktike në studio	Ushtrime
20	Bazat e editimit digjital	Përdorimi i Photoshop / Lightroom për retouching dhe balancë ngjyrash.	Ushtrime praktike dhe demonstrim në klase.	Ushtrime
21	Prezantim	Kritikë kolektive dhe diskutim mbi procesin e rikrijimit të fotografive.	Prezantim + kritikë	Prezantim
22	Alternative Processes	Prezantim i proceseve si photograms, watergrams, chemigrams, lumenprints, anotype, cyanotype	Workshop praktik	Detyra 7. Alternative Processes
23	Vazhdim i proceseve alternative	Kombinim i teknikave analoge.	Punë në laborator	Eksperimentim individual
24	Vazhdim i proceseve alternative	Kombinim i teknikave analoge.	Punë në laborator	Eksperimentim individual
25	Prezantim	Kritikë kolektive dhe diskutim mbi proceset alternative analoge.	Prezantim + kritikë	Prezantim

26	<i>Shikim filmi apo dokumentar</i>	Shikim filmi në klasë	Diskutim reflektiv me studentët.	Diskutim
27	<i>Përgatitja për ekspozitë / prezantim publik</i>	Kurimi i punëve për portofolio / ekspozitë.	Punë praktike në grup	Dorëzim i planit të prezantimit
28	<i>Ekspozita e punëve studentore</i>	Organizim, montim dhe prezantim publik.	Punë kolektive	Pjesëmarrje aktive
29	<i>Prezantimi final i projekteve</i>	Analizë personale mbi punën gjatë gjithë kursit	Vlerësim individual	Vlerësim përfundimtar
30	<i>Mbyllja e kursit dhe feedback i përgjithshëm</i>	Rishikim i njësive mësimore, komente për përmirësim të ardhshëm	Reflektim në grup	Mbyllje administrative

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Pjesëmarrja në ligjërata, ushtrime praktike dhe punë në terren është **e obligueshme**. Studentët pritet të jenë të përgatitur për çdo orë, të marrin pjesë aktivisht në diskutime dhe të dorëzojnë detyrat e tyre **brenda afateve të përcaktuara**. Pjesëmarrja në **kritikat vizuale**, diskutimet kolektive dhe prezantimet publike është pjesë përbërëse e procesit të vlerësimit.

Mësimdhënësi është në dispozicion për **konsultime individuale dhe grupore**, për të sqaruar aspektet teknike dhe konceptuale të punës fotografike. Studentët **inkurajohen të kërkojnë sqarime** gjatë orëve dhe të marrin iniciativë në procesin e tyre krijues.

Pas çdo ligjërate, studentët duhet të lexojnë **materialet e rekomanduara** dhe të përgatisin ushtrimet që lidhen me temën javore. Në kuadër të lëndës, kërkohet **përgjegjësi individuale, respekt për pajisjet fotografike dhe kujdes gjatë punës në studio dhe laborator. Plagjiatura dhe manipulimi joetik i imazhit nuk lejohen.**

Studentët duhet të respektojnë orarin, të jenë të rregullt në vijim, dhe të tregojnë sjellje profesionale gjatë ligjëratave, ushtrimeve dhe prezantimeve.